



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı



01 Nr. 074/26 Dt. 20.02.2026

Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Plani i Punës 2026

Të nderuar qytetarë të Prizrenit,

Viti 2026 shënon një etapë të re të zhvillimit të Komunës së Prizrenit, me fokus të qartë në avancimin e shërbimeve publike, realizimin e projekteve strategjike dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për të gjithë qytetarët. Duke u mbështetur në vizionin tonë për një qytet modern, funksional dhe të qëndrueshëm, angazhimi ynë do të orientohet në vazhdimin e projekteve infrastrukturore, modernizimin e hapësirave publike dhe zbatimin e zgjidhjeve të mençura që e bëjnë qytetin më efikas dhe më të organizuar.

Gjatë vitit 2026, prioritet i veçantë do të jetë vendosja e rendit dhe funksionalitetit në qytet, përmes menaxhimit më të mirë të hapësirave publike, përmirësimit të mobilitetit urban, rritjes së sigurisë, si dhe krijimit të një mjedisi më të pastër dhe më të rregullt për qytetarët dhe vizitorët. Paralelisht, do të vazhdojmë me përkushtim realizimin e projekteve infrastrukturore që ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik, social dhe urban të Prizrenit.

Një shtyllë e rëndësishme e këtij plani do të jetë thellimi i bashkëpunimit me organizatat vendore dhe ndërkombëtare, partnerët zhvillimorë dhe donatorët, me qëllim sigurim e mbështetjes profesionale dhe financiare për projekte me ndikim afatgjatë në komunë. Përmes këtyre partneriteteve synojmë të sjellim investime të reja, praktika të avancuara dhe mundësi të shtuara për zhvillim lokal.

Po ashtu, viti 2026 do të shënohet me një angazhim të veçantë në jetën kulturore dhe sportive të qytetit, duke e fuqizuar identitetin e Prizrenit si një qendër e rëndësishme e kulturës, rinisë dhe sportit. Në kuadër të vizionit të Prizrenit si qytet i sportit 2026, do të mbështeten aktivitetet sportive, infrastruktura përcjellëse, organizimi i ngjarjeve vendore dhe ndërkombëtare si dhe nismat që promovojnë pjesëmarrjen aktive të të rinjve dhe komunitetit.

Me përkushtim, transparencë dhe bashkëpunim, do të vazhdojmë të ndërtojmë një Prizren më të zhvilluar, më të rregullt dhe më dinamik, në shërbim të qytetarëve dhe gjeneratave të ardhshme.

Me respekt,

Shaqir Totaj!



Republika e Kosovës

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

OBJEKTIVAT E PROGRAMIT QEVERISËS PËR VITIN 2026

1. Menaxhimi Efektiv i Resurseve Humane dhe Financave Publike

- Përmirësimi i performancës së stafit komunal përmes trajnimeve dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm.
- Menaxhimi i buxhetit me transparencë dhe efikasitet për ta maksimizuar impaktin në projekte zhvillimore.

2. Promovimi i Prosperitetit Ekonomik në të Gjitha Zonat e Komunës

- Mbështetja e bizneseve lokale dhe nxitja e investimeve private dhe publike.

3. Ngritja e Cilësisë së Arsimit në të Gjitha Nivelet

4. Modernizimi i Shërbimeve Shëndetësore dhe Sociale

- Hapja e qendrave të reja shëndetësore dhe përmirësimi i pajisjeve ekzistuese.
- Rritja e qasjes dhe cilësisë së shërbimeve për shtresat më të ndjeshme të shoqërisë.

5. Zhvillimi i Infrastrukturës dhe Urbanistikës

- Rregullimi dhe mirëmbajtja e rrugëve, trotuareve dhe rrjeteve të kanalizimeve.
- Zhvillimi i zonave të reja urbane duke respektuar planifikimin urbanistik dhe mjedisor.

6. Prizreni i Gjelbër: Qytet i Qëndrueshëm dhe Miqësor me Mjedisin

- Shtimi i hapësirave të gjelbra dhe mbjellja e pemëve në zona urbane e rurale.
- Promovimi i energjive të ripërtërishme .

7. Zhvillimi i Rinisë, Kulturës dhe Sportit

- Investime në hapësirat sportive, kulturore dhe në aktivitete që promovojnë kreativitetin rinor.
- Organizimi i festivaleve dhe ngjarjeve ndërkombëtare për të nxitur pjesëmarrjen dhe njohjen globale.
- Organizimi i ngjarjeve sportive në kuadër të “Qyteti i Sportit 2026”



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

8. Nxitja e Turizmit si Sektor Strategjik

- Tërheqja e investimeve të mundshme.
- Bashkëpunimi me operatorët turistik dhe me hotelierë e gastronomë për t'i përmirësuar shërbimet turistike.

Aktivitetet drejt arritjes së objektivave do të bëhen nga drejtoritë përkatëse, stafi profesional i drejtorive, zyrat përgjegjëse dhe stafi i kabinetit tim. Ky plan është një dokument dinamik i cili mund të ndryshoj në vazhdimësi sipas nevojave, kërkesave dhe ngjarjeve.

KABINETI & ZYRAT E KRYETARIT

Objektivat e Kabinetit dhe Zyrave të Kryetarit

1. Qeverisje transparente dhe pjesëmarrëse

- Garantimi i qasjes së lehtë dhe në kohë në informata publike përmes publikimeve të rregullta dhe komunikimit institucional.
- Fuqizimi i llogaridhënies përmes dëgjimeve publike, takimeve konsultative dhe përfshirjes aktive të qytetarëve në proceset vendimmarrëse.
- Vlerësimi i performancës institucionale përmes treguesve të matshëm dhe raportimeve periodike.

2. Menaxhimi i prokurimeve

- Sigurimi i zbatimit transparent të planit të prokurimit dhe informimit të rregullt mbi proceset përkatëse.
- Mbikëqyrja e përputhshmërisë së procedurave me Ligjin e Prokurimit Publik dhe me prioritetet e drejtorive komunale.
- Përcjellja e afateve dhe realizimit të proceseve të prokurimit sipas planifikimeve vjetore.

3. Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe performancës së administratës

- Ofrimi i informimit të plotë dhe transparent për konkurset e punës, rezultatet dhe procedurat ankimore.
- Monitorimi i performancës së stafit në të gjitha drejtoritë dhe njësitë organizative të komunës.



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

- Përkrahja e zhvillimit profesional të administratës përmes trajnimeve dhe ngritjes së kapaciteteve.

4. Zbatimi i ligjeve dhe përputhshmëria me aktet rregullative

- Sigurimi i funksionimit të proceseve në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje, Statutin e Komunës dhe aktet e tjera nënligjore.
- Realizimi i veprimeve dhe aktiviteteve në përputhje me Agjendën Evropiane për Integritet Evropiane.

5. Bashkëpunim dhe zhvillim ndërinstitucional

- Realizimi i projekteve dhe bashkëpunimeve me komunitatet e tjera brenda dhe jashtë Kosovës, si dhe me organizatat ndërkombëtare.
- Inicimi dhe aplikimi për fonde, grante e projekte të ndryshme zhvillimore.

6. Auditimi dhe përmirësimi i proceseve

- Zbatimi i auditimeve të brendshme në përputhje me planin vjetor dhe legjislacionin në fuqi.
- Përcjellja e rekomandimeve të auditimit dhe zbatimi i masave për përmirësimin e proceseve.
- Forcimi i kontrollit të brendshëm dhe përgjegjësisë institucionale.

7. Promovimi i barazisë dhe gjithëpërfshirjes

- Garantimi i trajtimit të barabartë dhe përfshirjes së të gjitha komuniteteve që jetojnë në komunë.
- Promovimi i mundësive të barabarta në qasje ndaj shërbimeve komunale dhe proceseve vendimmarrëse.
- Përkrahja e politikave që fuqizojnë grupet e ndjeshme dhe nxisin kohezionin social. Këto objektiva do të shërbejnë si bazë për realizimin e planit të punës së Komunës së Prizrenit dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Planifikimi sipas drejtorive:

Gjatë vitit 2026, do të shtohen dy drejtori të reja: **Drejtoria e Tatimit në Pronë** dhe **Drejtoria e Pronave dhe Çështjeve Juridike**.



Republika e Kosovës

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria e Tatimit në Pronë

Drejtoria e Tatimit në Pronë do të përqendrohet në mbledhjen efikase dhe të rregullt të tatimeve mbi pronën, duke siguruar që proceset të jenë transparente dhe të qasshme për qytetarët. Përmes procedurave të përmirësuara dhe përdorimit të sistemeve digjitale, Drejtoria synon t'i maksimizojë të ardhurat komunale dhe të ofrojë shërbime cilësore e të shpejta për pronarët e pronave në të gjithë komunën.

Drejtoria e Pronës dhe Çështjeve Juridike

Drejtoria e Pronës dhe Çështjeve Juridike do të fokusohet në menaxhimin efikas të pronave komunale dhe zgjidhjen e çështjeve juridike që lidhen me to. Kjo do të përfshijë administrimin e pasurive, sigurimin e rregullsisë ligjore dhe bashkëpunimin me qytetarët për të garantuar përdorim të drejtë dhe transparent të pronave, duke kontribuar në rritjen e besimit dhe shërbimin efektiv ndaj komunitetit.

1. Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës

Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës ka për detyrë të sigurojë ofrimin e një arsimit cilësor, gjithëpërfshirës dhe të barabartë për të gjithë nxënësit e komunës, duke fuqizuar institucionet edukative, mësimdhënësit dhe bashkëpunimin me komunitetin dhe tregun e punës. Prandaj, kjo drejtori është e përkushtuar që t'i realizoj objektivat e saja me anë të aktiviteteve të prezantuara.

Objektivat kryesore dhe aktivitetet:

- **Qeverisje, udhëheqje dhe menaxhim cilësor në të gjitha institucionet edukative-arsimore të komunës**
 - Funkcionalizimi dhe fuqizimi i Këshillave Drejtues të Shkollave
 - Ngritja e kapaciteteve për udhëheqje dhe menaxhim
 - Ndërtimi i strukturës për menaxhim efektiv të arsimit në DKA
 - Krijimi i mekanizmave për vlerësim dhe stimulim të strukturave udhëheqëse të shkollave
 - Rishikimi dhe racionalizimi i rrjetit të shkollave në komunë
- **Mjedisi shkollor i përshtatshëm për zhvillimin e procesit mësimor dhe aktiviteteve jashtëmësimore**



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

- Analiza e gjendjes së sigurisë në shkolla dhe marrja e masave për plotësimin e nevojave më prioritare
- Ndërtimi i terreneve dhe sallave të edukatës fizike
- Hartimi i planit për mirëmbajtje teknike të shkollave

- **Përmirësim domethënës i cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit në shkolla**

- Fuqizimi i modelit "komuniteti i të mësuarit së bashku"
- Pajisja e shkollave me mjete TIK dhe rrjete lokale
- Furnizimi i shkollave me mjete elementare të konkretizimit (0-5)
- Pajisja e shkollave me laboratorë të ndryshëm

- **Ndërtimi i vazhdueshëm i kapacitetit për mësimdhënie cilësore**

- Identifikimi i nevojave të mësimdhënësve për trajnime
- Organizimi i trajnimeve në nivel komune dhe me bazë në shkollë
- Nxitja e monitorimit dhe shkëmbimit të përvojave mes kolegëve
- Themelimi i Qendrës Didaktike dhe mbështetja për ngritje profesionale
- Krijimi i mekanizmave efikas për financimin e zhvillimit profesional të mësimdhënësve
- Angazhimi i drejtorëve të shkollave për monitorim të vazhdueshëm të mësimdhënësve lidhur me zbatimin e metodologjive bashkëkohore
- Ngritja e kapaciteteve të shkollës për vlerësimin e performancës së mësimdhënësve
- Krijimi i mekanizmave funksionalë për stimulim të mësimdhënësve të suksesshëm

- **Përmirësim i vazhdueshëm i cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit në shkolla**

- Përkrahja e koordinatorëve të cilësisë me bazë në shkollë
- Caktimi i fondeve për ndërtim, renovim, zgjerim dhe mirëmbajtje të infrastrukturës shkollore
- Furnizimi i shkollave me kompjuterë dhe infrastrukturë TIK
- Pajisja e shkollave me pako të veglave për lëndën e edukatës fizike
- Ndërtimi dhe fuqizimi i mekanizmave për sigurimin e cilësisë në nivel shkollor dhe komunal
- Fuqizimi i aktiveve profesionale në shkolla

- **Bashkëpunim cilësor dhe efikas mes hisedarëve të edukimit të hershëm**



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

- Stimulimi i hapjes së institucioneve të edukimit parashkollor përmes partneriteteve publiko-private
 - Bashkëpunimi me MASHT/SIA për licencimin e IPEH
 - Ndërgjegjësimi i komunitetit për përfshirje në edukimin e hershëm dhe parafillor
 - Bashkëpunim i shtuar me institucionet private të edukimit të hershëm
- **Ndërlidhja më e mirë e arsimit profesional me tregun e punës**
- Identifikimi i nevojave të tregut të punës
 - Përshtatja e kurrikulave dhe programeve të studimit
 - Pjesëmarrja aktive e industrisë në procesin mësimor
 - Monitorimi dhe vlerësimi i efikasitetit të trajnimit

2. Drejtoria e Shërbimeve Publike

Drejtoria e Shërbimeve Publike mbulon një gamë të gjerë të fushëveprimit, që përfshin ndërtimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës rrugore, ujësjellësve, kanalizimeve, ndriçimit publik, hapësirave të gjelbra dhe shërbimeve publike të qytetit.

Objektivat e drejtorisë përfshijnë:

- Hartimin e planeve dhe projekteve konkrete afatshkurtra dhe afatmesme.
- Përpilimin e rregulloreve dhe vendimeve përkatëse.
- Ofrimin e shërbimeve profesionale dhe efikase për qytetarët e Komunës së Prizrenit.
- Bashkëpunimin me drejtoritë tjera në planifikimin e buxhetit dhe realizimin e investimeve kapitale.
- Monitorimin dhe kontrollimin e projekteve në të gjitha fushat e kompetencës së DSHP-së.

Aktivitetet kryesore për vitin 2026 përfshijnë:

1. Infrastrukturë rrugore dhe urbanistike

- Ndërtimi, riparimi dhe mirëmbajtja e rrugëve me asfalt dhe kalldrëm.
- Rregullimi i rrugëve lokale dhe rajonale, përfshirë mbushjen e gropave dhe meremetimin e rrugëve të asfaltuara.
- Ndërtimi i urave dhe mureve mbrojtëse.
- Hapja e rrugëve pyjore dhe rrugëve alternative.



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

2. Infrastrukturë ujore dhe kanalizime

- Ndërtimi dhe rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe rezervuarëve.
- Rehabilitimi i rrjetit ekzistues të ujësjellësit dhe kanalizimeve.
- Pastrimi i pusetave dhe ujmbledhësve në rrjetin e kanalizimit.

3. Ndriçimi publik dhe sinjalizimi

- Instalimi i ndriçimit publik dhe riparimi i ndriçimit ekzistues.
- Shenjzimi horizontal, vertikal dhe sinjalizues i rrugëve e shesheve.

4. Hapësirat publike dhe gjelbërimi

- Ndërtimi dhe rehabilitimi i miniparqeve dhe hapësirave të gjelbra.
- Pastrimi, mirëmbajtja dhe rregullimi i hapësirave publike, parqeve dhe oazave.
- Mbjellja e fidanëve drunorë dhe krijimi i hapësirave të reja sipas planeve urbanistike.

5. Transport publik dhe licencime

- Licencimi i linjave urbane dhe urbane-periferike të transportit publik.
- Kontrolli dhe licencimi i auto-taksive të qytetit.
- Lëshimi në qarkullim i autobusëve lokalë dhe mbikëqyrja e zbatimit të rregulloreve.

6. Projekte të veçanta dhe të vazhdueshme

- Ndërtimi i tregut të gjelbër dhe parkingut nëntoksor.
- Rekonstruktimi i rrugëve dhe trotuareve në lagjet kryesore të qytetit.
- Rindërtimi dhe rehabilitimi i infrastrukturës në zona të mbrojtura historike.
- Ndërtimi i projekteve turistike, kulturele dhe rekreative si shtigje dhe teleferikë. Disa prej projekteve kryesore që do realizohen gjatë vitit:



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Disa nga projektet kryesore:

	Emërtimi
1	Ndërtimi dhe rehabilitimi i miniparqeve në lagjet Lakuriq, Bazhdarhane, Ortakoll dhe lagjen 4 Kullat
2	Ndërtimi, riparimi dhe mirëmbajtja e rrugëve me asfalt
3	Ndërtimi me asfalt i rrugës dhe murit mbrojtës në Manastiricë
4	Ndërtimi i infrastrukturës në Grazhdanik, rrugët dhe kanalizimi - Projekt dyvjeçar
5	Ndërtimi i rrugës Medvec - Smaç
6	Ndërtimi i Infrastrukturës në fshatin Kobajë - rrugë dhe kanalizim
7	Ndërtimi i Infrastrukturës në Gjonaj
8	Hapja e rrugës pyjore "Udha e staneve" në Vërmicë
9	Ndërtimi i kanalizimit të hapur, mureve mbrojtës dhe rregullimi i rrugicave në fshatin Krushë e Vogël
10	Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit dhe ndërtimi i rezervuarit në Lubizhdë
11	Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe vendosja e ujëmatësve jashtë pronës private në fshatin Zhur
12	Instalimi i ndriçimit publik dhe riparimi i ndriçimit ekzistues
13	Rregullimi i rrugëve, kanalizimit, ujësjellësit dhe ndriçimit publik në Lagjen "Dardania II" - faza II dhe III
14	Rregullimi i rrugëve, kanalizimit, ujësjellësit dhe ndriçimit publik në Lagjen "Dardania II" - faza I
15	Ndërtimi i Infrastrukturës të shkollës së Dardanisë
16	Zhvendosja e objekteve elektrike
17	Ndërtimi i Infrastrukturës në Romajë - rrugë dhe ndriçim publik
18	Asfaltimi i rrugës Lybiqevë - Jeshkovë
19	Ndërtimi i shtratit të Lumbardhit nga ura afër kampusit universitar në vazhdim të rrjedhës
20	Intervenime në infrastrukturë për rastet e fatkeqësive
21	Ndërtimi i rrugëve lokale në fshatin Korishë
22	Ndërtimi i rrugës alternative Skorobisht – Lubizhdë - Projekt tre vjeçar
23	Ndërtimi i infrastrukturës në Landovicë
24	Ndërtimi me kalldrëm i rrugës në Jeshkovë - Projekt dy vjeçar
25	Shenjëzimi horizontal, vertikal dhe sinjalizues në qytet dhe fshatrat e Komunës së Prizrenit



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

26	Pastrimi i pusetave dhe ujmbledhësve në rrjetin e kanalizimit në Komunën e Prizrenit - Projekt tre vjeçar
27	Furnizim me kablo të tensionit të mesëm dhe shërbimet përcjellëse
28	Ndërtimi i urës në fshatin Zojz
28	Ndërtimi i rrugëve dhe trotuareve në lagjen "2 Korriku"
29	Rehabilitimi dhe revitalizimi i hapësirave në zonën e parë të objekteve të mbrojtura, kryesisht në pjesën e vjetër të qytetit të Prizrenit
30	Ndërtimi i infrastrukturës në lagjen "Bajram Curri"
31	Ndërtimi i infrastrukturës në Tupec
32	Zhvillimi i databazës dhe sistemit web Gis për shërbimet publike në Komunën e Prizrenit
33	Ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimit në lagjen "Arbana"
34	Incizimet gjeodezike për projektet e DSHP-së
35	Rehabilitimi dhe rindërtimi i rrugëve me kubëza, trotuareve dhe shesheve në lagjet Ortakoll, Bajram Curri, Arbanë, Jeta e re
36	Rehabilitimi i kanalizimit dhe ujësjellësit në pjesën kryesore të qytetit: Shadërvan, Ortakoll, Bajram Curri, Arbanë
37	Hartimi i projektit të detajuar sipas nevojave të DSHP-së
38	Ndërtimi i rrugës Shpenadi - Lubizhdë
39	Rregullimi i përrockës në Randobravë
40	Hartimi i projektit të detajuar për ndërtimin e teleferikut për në Kalanë e Prizrenit
41	Rregullimi i infrastrukturës dhe renovimi i objektit të Stacionit të Autobusëve
42	Ndërtimi i infrastrukturës në lagjen Jeta e re - rrugë, kanalizim dhe ujësjellës
43	Ndërtimi i rrugës nga shkolla e Novoselanit deri në Vërbiçan
44	Rekonstruimi i rrugës "Ekrem Rexha" në Lubizhdë të Prizrenit
45	Zhvillimi i shtigjeve për turizëm, kulturë dhe rekreacion në Kalanë e Prizrenit
46	Ndërtimi i tregut të gjelbër dhe parkingut nëntokësor

Drejtoria e Shërbimeve Publike mbetet e përkushtuar në ofrimin e shërbimeve cilësore dhe zhvillimin e infrastrukturës së qëndrueshme për qytetarët e Prizrenit.



Republika e Kosovës

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

3. Drejtoria e Inspektorateve

Drejtoria e Inspektorateve, në përputhje me legjislacionin në fuqi, aktet nënligjore, vendimet komunale dhe prioritetet strategjike të Komunës së Prizrenit, gjatë vitit 2026 do të angazhohet në garantimin e zbatimit të ligjshmërisë, mbrojtjen e interesit publik, ruajtjen e rendit urban, mbrojtjen e mjedisit, sigurinë e konsumatorit dhe kontrollin e zhvillimit ndërtimor në territorin e Komunës së Prizrenit.

Veprimtaria e drejtorisë do të realizohet përmes tre sektorëve funksionalë: **Sektorit Komunal, Sektorit të Tregut dhe Sektorit të Ndërtimit**, me fokus në mbikëqyrjen sistematike të terrenit, trajtimin efikas të kërkesave të qytetarëve, ndërhyrjet sipas kompetencave ligjore dhe bashkëpunimin e ngushtë ndërinstitucional.

Objektivat strategjike:

- Sigurimi i zbatimit të plotë të ligjeve dhe akteve nënligjore në fushat inspektuese.
- Përmirësimi i rendit, sigurisë dhe funksionalitetit të hapësirave publike.
- Parandalimi dhe reduktimi i ndotjes së mjedisit dhe zhurmave urbane.
- Luftimi i ekonomisë informale dhe forcimi i mbrojtjes së konsumatorit.
- Parandalimi i ndërtimeve pa leje dhe garantimi i respektimit të standardeve ndërtimore.
- Rritja e efikasitetit në trajtimin e ankesave, kërkesave dhe rasteve emergjente.
- Thëllimi i bashkëpunimit me Policinë e Kosovës, organet e drejtësisë dhe drejtoritë relevante komunale.

Aktivitetet:

Në kuadër të **Sektorit Komunal**, do të realizohen inspektime të rregullta për pastërtinë publike, menaxhimin e mbeturinave, shfrytëzimin e hapësirave publike, largimin e pengesave dhe reklamave pa leje, kontrollin e objekteve të përkohshme si dhe mbikëqyrjen e infrastrukturës publike dhe transportit lokal.

Në kuadër të **Sektorit të Tregut**, fokusi do të jetë në mbikëqyrjen e aktivitetit ekonomik, luftimin e ekonomisë informale, kontrollin e çmimeve, deklarimit të produkteve, kushteve minimale teknike, sigurisë së produkteve, mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit dhe inspektimet e përbashkëta me institucionet përgjegjëse.



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në kuadër të **Sektorit të Ndërtimit**, prioritet do të jetë inspektimi sistematik i terrenit sipas zonave, verifikimi i dokumentacionit ndërtimor, identifikimi dhe trajtimi i ndërtimeve pa leje, ekzekutimi i vendimeve të formës së prerë për rrënim, kontrolli i materialeve ndërtimore, eliminimi i rrezikshmërisë gjatë fazës së ndërtimit dhe trajtimi i objekteve me potencial rreziku për sigurinë publike.

Përmes realizimit të këtij plani, synohet rritja e nivelit të ligjshmërisë, përmirësimi i rendit urban dhe tregtar, mbrojtja më efektive e mjedisit dhe konsumatorit, reduktimi i ndërtimeve ilegale dhe forcimi i besimit të qytetarëve ndaj institucioneve komunale.

4. Drejtoria e Urbanizimit dhe Planifikimit Hapësinor

Në kuadër të planifikimit strategjik, Drejtoria e Urbanizimit dhe Planifikimit Hapësinor planifikon:

Prioritetet kryesore:

- Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal (PZHK);
- Trajtimi i ndërtimeve pa leje dhe procesi i legalizimit të objekteve;
- Hapja e rrugëve sipas Hartës Zonale Komunale (HZK);
- Rehabilitimi i kulmeve dhe korridoreve në objektet e banimit kolektiv;
- Hartimi i planeve të rregullta urbane sipas HZK.

Ky plan synon përmirësimin e zhvillimit hapësinor, rritjen e rregullsisë ndërtimore dhe avancimin e kushteve urbane për qytetarët e Komunës së Prizrenit.

5. Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në përputhje me planifikimin buxhetor dhe prioritetet strategjike të Komunës së Prizrenit, gjatë vitit 2026 do të fokusohet në fuqizimin e shërbimeve sociale dhe familjare, mbështetjen e kategorive të cënueshme, përmirësimin e infrastrukturës sociale dhe zgjerimin e bashkëpunimit me partnerët institucionalë dhe organizatat joqeveritare.

Veprimtaria e drejtorisë do të orientohet në ofrimin e mbrojtjes sociale cilësore për familjet në nevojë, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, familjet strehuese dhe kategoritë tjera të cënueshme, përmes shërbimeve rezidenciale, subvencioneve, projekteve infrastrukturore dhe programeve të mbështetjes direkte.



Republika e Kosovës

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Objektivat strategjike:

- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve sociale dhe familjare.
- Zgjerimi i kapaciteteve infrastrukturore për strehim dhe kujdes social.
- Mbështetja e familjeve skamnore dhe kategorive të cënueshme përmes subvencioneve dhe asistencës materiale.
- Fuqizimi i mbrojtjes së fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara.
- Thellimi i bashkëpunimit me OJQ-të dhe partnerët donatorë.
- Hartimi dhe miratimi i dokumenteve strategjike komunale në fushën sociale.

Aktivitetet:

Gjatë vitit 2026 do të vazhdojnë projektet infrastrukturore sociale, përfshirë:

- ndërtimin e banesave sociale,
- shtëpisë emergjente për mbrojtjen e fëmijëve,
- përmirësimin e objekteve të Qendrës për Punë Sociale,
- shtëpive rezidenciale dhe shtëpisë së të moshuarve,
- investimet në pajisje, inventar dhe qasje për personat me aftësi të kufizuara.

Po ashtu, drejtoria do të realizojë programe të mbështetjes direkte për familjet në nevojë përmes pakove ushqimore e higjienike, subvencionimit të qirasë, mbështetjes për familjet strehuese, furnizimit me dru, medikamente, ushqim, veshmbathje dhe shërbime të tjera sociale.

Një fokus i veçantë do t'i kushtohet bashkëpunimit me organizatat joqeveritare për projekte të përbashkëta sociale si dhe hartimit të statuteve dhe planeve komunale për mbrojtjen e fëmijëve, strehimin familjar dhe trajtimin e fëmijëve në situatë rruge.

Përmes këtij plani synohet përmirësimi i mirëqenies sociale, rritja e qasjes në shërbime sociale cilësore, përmirësimi i kushteve të banimit për familjet në nevojë dhe forcimi i mekanizmave lokalë për mbrojtjen sociale dhe familjare.



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

6. Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit synon t'i zhvillojë dhe fuqizojë sektorët e saj përmes projekteve kulturore, rinore dhe sportive, duke promovuar bashkëpunimin, kreativitetin dhe pjesëmarrjen qytetare gjatë vitit 2026.

Objektivat kryesore:

1. Përmirësimi i infrastrukturës së brendshme të institucioneve vartëse të drejtorisë;
2. Ngritja e nivelit të përgjegjësisë në monitorimin dhe raportimin për të gjitha projektet;
3. Partneriteti i Teatrit "Bekim Fehmiu" me OJQ "Prizren Fest" për realizimin e festivalit të teatrove;
4. Ngritja e nivelit të performancës së Ansambleve të qytetit, duke i subvencionuar dhe mbështetur me çështjet teknike dhe mjete ndihmese (rekuizita);
5. Avancimi i bashkëpunimit me OJQ-të, klubet sportive dhe aktorë të tjerë të bashkëpunimit;
6. Subvencionimi i klubeve sportive sipas kriterëve të përcaktuara;
7. Subvencionimi i OJQ-ve, shoqatave dhe grupeve të tjera të interesit për projektet me interes për qytetin;
8. Përkrahja e nismave për ngritjen e vetëdijes së qytetarëve për rëndësinë e kultivimit të kulturës, ruajtjes së shëndetit dhe bashkëpunimit me të rinjtë e rajonit;
9. Respektimi i kalendarit të festave të vendit sipas rrjedhës së zakonshme;
10. Fuqizimi i stafit të DKRS-së dhe institucioneve vartëse.

DKRS zotohet që, duke marrë për bazë ligjet që rregullojnë qeverisjen lokale, aktet nënligjore dhe rregulloret e Kuvendit të Komunës së Prizrenit, do t'i përmbushë në përpikëri të gjitha planifikimet e saj për këtë vit.

- Sektori Kulturës

Veprimtaria botuese:

- Revista kulturore artistike dhe letrare (dhjetor).
- Botimi i titujve nga autorë vendës (maj).

Aktivitete tradicionale:

- Gara komunale e recituesve të rinj;
- Festivali i Këngës së Fëmijëve (qershor);



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

- Spektakli për fëmijë gjatë Vitit të Ri;
- Ekspozita e Nëntorit dhe Çmimi për artistët e arteve pamore;
- Ditët e Kulturës: koncerte, ekspozita, panaire, shfaqje teatrale, ëorkshop-e, turne lokale dhe kombëtare;
- Takim me mërgimtarët dhe orë letrare;
- Dita e Muzikës Klasike (shtator-tetor).

Kremtimi i festave kombëtare:

- 17 Shkurt – Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës;
- 10–12 Qershor – Dita e Lidhjes Shqiptare dhe Çlirimit të Prizrenit;
- 28 Nëntor – Dita e Flamurit Kombëtar.

Institucionet vartëse – Biblioteka Komunale:

- Dita e Bibliotekës (dhjetor);
- Java e Leximit dhe Java e Bibliotekës (prill);
- Funksionalizimi i platformës KOHA për digjitalizim dhe trajnime të stafit.

Teatri i Qytetit:

- Tri shfaqje teatrale (2 për të rritur, 1 për fëmijë), një në bashkëprodhim me Teatrin Eksperimental në Tiranë;
- Mbajtja e repertorit të rregullt dhe shfaqjeve mysafire;
- Platforma CONTEMPORA për lexime skenike dhe promovim të dramaturgjisë bashkëkohore;
- Pajisja me teknologji dhe mjete për staf;
- Organizimi i Ditës Përkujtimore të Bekim Fehmiut.

OJQ kulturore:

- Pajisja me rekuizita dhe mbështetje për projekte.

Nxitja e krijimtarisë artistike:

- Mbështetje për talentë të rinj dhe pjesëmarrje e trupave artistike në festivale vendore dhe ndërkombëtare.



Republika e Kosovës

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

- **Sektori Sportit**

Prioritetet kryesore:

- Sporti cilësor – subvencionimi i klubeve;
- Masovizimi i sportit dhe garat shkollore;
- Organizimi i turnireve tradicionale;
- Mirëmbajtja dhe avancimi i infrastrukturës sportive;
- Vizita dhe monitorim i objekteve sportive;
- Takime të rregullta me klubet;
- Mbështetje e projekteve dhe aktiviteteve;
- Puna administrative dhe arkivimi;
- Zgjedhja e më të mirëve në fushën e sportit (Dekorata/Çmime).

Qyteti Evropian i Sportit 2026:

- Angazhimi për organizimin e aktiviteteve sportive në të gjithë komunën.

- **Sektori Rinisë**

- Promovimi i pjesëmarrjes aktive të të rinjve në proceset shoqërore;
- Krijimi i mundësive për punësim dhe zhvillim individual;
- Edukimi dhe parandalimi i dukurive të dëmshme;
- Fuqizimi i Qendrës Rinore dhe siguria njerëzore;
- Teatri i të rinjve për zhvillim kulturor, kreativitet dhe vetëbesim;
- Integrim social, ndër-etnik dhe vullnetarizëm;
- Bashkëpunim me OJQ-të, institucione dhe projekte rinore;
- Thirrje publike për financimin dhe mbështetjen e iniciativave rinore.

7. Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik

Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit dhe fuqizimi i ekonomisë lokale përmes mbështetjes së bizneseve, promovimit të Prizrenit si destinacion turistik dhe krijimit të mundësive të reja për punësim dhe investime.



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Objektivat:

- **Zhvillimi dhe promovimi i turizmit lokal** – Rritja e numrit të vizitorëve dhe përmirësimi i imazhit turistik.
 - Plan vjetor promovimi; bashkëpunim me operatorë turistikë, OJQ dhe sektorin privat; koordinim i aktiviteteve kulturore, sportive dhe turistike; përmirësim i materialeve promovuese.
- **Mbështetja e bizneseve dhe zhvillimi ekonomik lokal** – Fuqizimi i bizneseve dhe nxitja e sipërmarrjes.
 - Programe mbështetëse për biznese; trajnime dhe punëtori; bashkëpunim me odat ekonomike dhe institucionet relevante; lehtësim i komunikimit me administratën komunale.
- **Tërheqja e investimeve dhe projekteve zhvillimore** – Rritja e interesit të investitorëve dhe realizimi i projekteve ekonomike.
 - Identifikimi i mundësive investive; bashkëpunim me donatorë dhe partnerë ndërkombëtarë; përgatitja e projekteve për financim; promovimi i potencialeve ekonomike.
- **Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm dhe rural** – Diversifikimi i ofertës dhe mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore.
 - Mbështetje për turizmin rural dhe malor; bashkëpunim me komunitetet lokale; promovimi i produkteve tradicionale; integrimi i qëndrueshmërisë në politikat turistike.
- **Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe koordinimi ndërsektorial** – Rritja e efikasitetit dhe bashkëpunimit institucional.
 - Koordinim me drejtoritë komunale; monitorim dhe raportim i projekteve; përmirësim i procedurave të punës; rritja e transparencës dhe komunikimit me qytetarët.
- **Investime në trashëgimi natyrore dhe hapësira publike turistike** – Ruajtja dhe valorizimi i burimeve natyrore.



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

- Identifikimi i krojeve, burimeve dhe zonave natyrore; investime për rregullimin dhe funksionalizimin e tyre; përmirësimi i hapësirave përreth; bashkëpunim me drejtoritë për mirëmbajtje dhe mbrojtje.

Kalendari i aktiviteteve:

- **Janar – Shkurt:** Aktivitetet dimërore dhe promovimi i turizmit kulturor.
- **Mars:** Promovimi i trashëgimisë kulturore dhe javë tematike për artizanatin lokal.
- **Prill:** Aktivitetet pranverore, ecje turistike dhe promovim i zonave rurale.
- **Maj:** Java e Gastronomisë së Prizrenit – kuzhinë tradicionale, produkte lokale, panair ushqimor.
- **Qershor:** Aktivitete sportive rekreative dhe promovim i turizmit aktiv.
- **Korrik:** Festival Kulturor Veror – muzikë, teatër, art dhe trashëgimi kulturore.
- **Gusht:** Aktivitete sportive verore në zona malore dhe hapësira natyrore.
- **Shtator:** Promovimi i turizmit rural dhe agroturizmit, ditë të produkteve tradicionale.
- **Tetor:** Ecje turistike dhe promovim i krojeve dhe burimeve natyrore.
- **Nëntor:** Panaire ekonomike dhe artizanale, takime me biznese turistike.
- **Dhjetor:** Aktivitete festive dhe promovim i turizmit dimëror dhe kulturor.

8. Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave

Plani i punës për Drejtorinë e Financave për vitin 2026 fokusohet në garantimin e menaxhimit efikas të burimeve financiare të Komunës, duke përmirësuar proceset e planifikimit buxhetor, mbikëqyrjes financiare dhe transparencës, si dhe duke siguruar që shpenzimet publike të jenë të qëndrueshme dhe në përputhje me nevojat e qytetarëve dhe zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit.

Plani i punës për vitin 2026 për sektorët:

- Tatimi në pronë,
- Buxhet dhe planifikim,
- Financa dhe kontabiliteti,
- QKB (Qendra Komunale e Bizneseve) të Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave

Aktivitetet sipas muajve për departamentin e Tatimit në Pronë:



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Muaji	Aktivitetet kryesore
Janar	Përgatitja e raporteve vjetore, verifikimi në teren
Shkurt	Pranimi dhe shqyrtimi i ankesave për pronë, procedurat për inkasim
Mars	Fillimi i procedurave për inkasim
Prill	Shpërndarja e faturave, verifikimi i objekteve
Maj	Pranimi dhe shqyrtimi i ankesave për pronë
Qershor	Fillimi i procedurave për inkasim
Korrik	Verifikimi i objekteve
Gusht	Pranimi dhe shqyrtimi i ankesave për pronë
Shtator	Raporti gjashtëmujor
Tetor	Verifikimi i objekteve
Nëntor	Fillimi i procedurave për inkasim
Dhjetor	Përgatitja e raporteve vjetore

Aktivitetet sipas muajve për departamentin për Buxhet dhe Financa:

Përgatitja e pasqyrave, trajnime, debate publike, planifikim buxheti 2026-2029.

Muaji	Aktivitetet kryesore
Janar	Përgatitja e pasqyrave financiare 2025
Shkurt	Trajnime të drejtorëve dhe menaxherëve
Mars	Zotimet e mjeteve për drejtoritë, raporte të tjera
Prill	Hartimi i Strategjisë dhe Lista e Rrezeve
Maj	Përgatitja e raportit për subvencione
Qershor	Përgatitja e Cash planit për vitin 2026
Korrik	Hartimi dhe përgatitja e raportit vjetor 2025
Gusht	Plotësimi i vetvlerësimit 2025
Shtator	Aprovimi i zotimeve, raportimi Janar-Qershor 2026
Tetor	Përgatitje për rishikim të buxhetit 2026
Nëntor	Debat në Kuvend për KAB 2027-2029
Dhjetor	Aprovimi i Buxhetit 2027-2029 - futja në sistem

Aktivitetet sipas muajve për departamentin e Financave dhe Kontabilitetit:

Regjistrime, barazime, raportim, arkivim, përgatitje pagesash, alokime.



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Muaji	Aktivitetet kryesore
Janar	Përgatitjet e pasqyrave financiare
Shkurt	Barazimi vjetor, regjistrime të HV dhe shpenzimeve
Mars	Regjistrimet e shpenzimeve të procesuara dhe barazimi me thesarin
Prill	Përgjegjësia e raporteve të shpenzimeve për drejtori
Maj	Barazimet me drejtoritë për të HV
Qershor	Skanimi dhe arkivimi i lëndëve
Korrik	Përgatitjet e lëndëve për pagesa
Gusht	Regjistrimet e HV, shpenzimeve dhe barazimeve me thesarin
Shtator	Përgatitje e alokimeve nga të HV të mbledhura
Tetor	Barazimet me drejtoritë për të HV dhe percjellja e raporteve
Nëntor	Skanimi dhe arkivimi i lëndëve
Dhjetor	Përgatitjet e lëndëve për pagesa, barazimet tremujore me MEF

Aktivitetet sipas muajve në departamentin QKB (ARBK)

Veprimtari kryesore: Raportimi mujor dhe periodik, njoftime për çrregjistrime

Muaji	Aktivitetet kryesore
Janar	Raportimi mujor
Shkurt	Raportimi mujor
Mars	Raportimi mujor
Prill	Raportimi mujor dhe njoftim për çrregjistrime
Maj	Raportimi mujor dhe tremujor
Qershor	Raportimi mujor
Korrik	Raportimi mujor
Gusht	Raportimi gjashtëmujor
Shtator	Raportimi mujor
Tetor	Raportimi mujor dhe njoftim për çrregjistrime
Nëntor	Raportimi mujor dhe nëntëmujor
Dhjetor	Raportimi mujor

Ky plan ka në fokus menaxhimin e tatimeve, buxhetit, financave dhe raportimeve për sektorët përkatës.



Republika e Kosovës

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

9. Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka për qëllim mbështetjen e sektorit bujqësor dhe zhvillimit rural. Kjo përfshin investime kapitale, subvencione, projekte me bashkëfinancim, shërbime dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të fermerëve.

Objektivat kryesore:

- Shfrytëzimi efikas dhe i qëndrueshëm i burimeve natyrore dhe të tjera.
- Rritja e prodhimit bujqësor dhe përmirësimi i zinxhirit të vlerës.
- Mbështetje financiare për fermat dhe ekonomitë familjare.
- Krijimi i mundësive të punësimit në zonat rurale përmes diversifikimit të aktiviteteve.

Prioritetet Strategjike për 2026:

1. Shtimi i sipërfaqeve të punueshme të tokës bujqësore.
2. Rritja e numrit të fermave dhe ekonomive familjare.
3. Përmirësimi i parcelave bujqësore dhe kapaciteteve prodhuese.
4. Ngritja e kapaciteteve profesionale në sektorin bujqësor.

Projektet kryesore:

- Rehabilitimi i rrugëve fushore,
- Rehabilitimi i kanaleve ujitëse dhe kullimit të tokave,
- Furnizimi me mekanizim bujqësor,
- Ngritja e serrave dhe stallave .

Projektet me Bashkëfinancim:

- Ngritja e vreshtave dhe investime të vogla për pemishte,
- Projekte të vogla për zhvillim rural.

Shërbime Bujqësore:

- Inseminimi artificial i lopëve dhe vaksinimi i deleve dhe dhive,
- Dezinfektimi dhe deratizimi i qytetit dhe periferisë,
- Trajtimi i qenve endacakë.



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Subvencionet:

- Subvencionimi i bletëve,
- Subvencionimi i qumështit,
- Subvencionimi i deleve, dhive dhe shpendarisë,
- Mbështetje për prodhimin e vezëve dhe mjaltit.

Metodologjia e Zbatimit:

- Të gjitha thirrjet për aplikim do të publikohen në faqen zyrtare të Komunës së Prizrenit,
- Aplikacionet e paplota nuk pranohen,
- Vlerësimi bëhet sipas kriterëve të parashikuara dhe prioritetet komunale.

10. Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër

Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër fokusohet në ofrimin e shërbimeve efektive dhe të shpejta për qytetarët dhe institucionet, duke zbatuar politikat dhe ligjet në fuqi.

Objektivat kryesore:

Përfundimi i lëndëve brenda afateve ligjore – Përpunimi dhe përfundimi i kërkesave të qytetarëve dhe institucioneve brenda kohës së parashikuar ligjërisht.

Thjeshtësimi i procedurave – Lëshimi i certifikatave të pronës dhe dokumenteve të tjera kadastrale në mënyrë të menjëhershme në sportel.

Realizimi i të hyrave – Përbushja e planeve për të hyrat e përcaktuara nga kuvendi.

Regjistrimi i komasacionit – Rregullimi i regjistrimeve kadastrale në bashkëpunim me Agjencinë Kadastrale të Kosovës.

Ky plan siguron që shërbimet e ofruara të jenë në përputhje me kërkesat e qytetarëve dhe institucionet, duke ruajtur efikasitetin dhe transparencën në çdo proces.



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

11. Drejtoria e Emergjencave dhe Sigurisë

Drejtoria e Emergjencave dhe Sigurisë për vitin 2026 ka planifikuar këto projekte dhe aktivitete në bazë të buxhetit të planifikuar:

Projekte Kryesore:

- Vendosja dhe mirëmbajtja e kamerave të sigurisë në Komunën e Prizrenit (kontratë kornizë 3 vjeçare),
- Pajisje për Brigadën e Zjarrfikësve,
- Ndërtimi i mureve mbrojtëse për rrëshqitjet e dheut (kontratë kornizë 3 vjeçare),
- Blerja e një automjeti special për zjarrfikësit.

Hartimi i Planeve:

- Vlerësimi i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe të tjera.
- Hartimi i planit operativ emergjent lokal dhe planit të evakuimit për shkolla dhe objekte me rëndësi të veçantë.
- Plani për reagim emergjent nga rrëshqitjet e dheut.
- Raportet e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë dhe raportet e Komisionit

Qëllime dhe Objektiva:

- Rritja e kapaciteteve dhe cilësisë së punës në terren dhe përmirësimi i standardeve të sigurisë.
- Mbrojtja e jetës dhe pasurisë së qytetarëve të Prizrenit, parandalimi i rreziqeve dhe aksidenteve.
- Trajnimi i stafit të Brigadës së Zjarrfikësve dhe përfaqësuesve të lagjeve për mbrojtje nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore.
- Përmirësimi i kushteve të punës për zjarrfikësit dhe rritja e numrit të stafit profesional.
- Funkcionalizimi i nënstacioneve të zjarrfikësve në Zhur, Gjonaj dhe Reçan.
- Inspektimi i shkallëve emergjente në banesat kolektive dhe bashkëpunimi me institucionet e sigurisë si FSK-ja dhe Policia e Kosovës.

Masat dhe Aktivitetet:

- Inspektime të rregullta dhe të jashtëzakonshme.



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

- Vërtetimi i pajisjeve dhe lëshimi i pëlqimeve nga AME.
- Realizimi i ushtrimeve dhe trajnimeve për zjarrfikësit dhe stafin.
- Njoftimi i qytetarëve për alarme dhe mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore.

Ky plan ka për qëllim përmirësimin e sigurisë dhe mbrojtjes së qytetarëve si dhe rritjen e efikasitetit në përballimin e emergjencave.

12. Drejtoria e Shëndetësisë

Drejtoria Komunale e Shëndetësisë, bazuar në buxhetin e planifikuar për vitin 2026, synon avancimin e infrastrukturës shëndetësore, rritjen e cilësisë së shërbimeve në kujdesin parësor, fuqizimin e kapaciteteve profesionale të stafit dhe zgjerimin e aktiviteteve parandaluese e promovuese në shëndet publik. Përmes investimeve kapitale, furnizimit me pajisje dhe material esencial si dhe ofrimit të pandërprerë të shërbimeve shëndetësore, DKSH-ja do të fokusohet në përmirësimin e qasjes dhe efikasitetit të sistemit shëndetësor lokal.

Objektivat kryesore:

1. Përmirësimi i infrastrukturës dhe kapaciteteve të objekteve shëndetësore

Aktivitete:

- Vazhdimi i ndërtimit të QMF-së në lagjen Tusus.
- Ndërtimi i AMF-së në fshatin Vlashnje.
- Ndërtimi dhe projektimi i QMF-së në fshatin Piranë.
- Instalimi i ngrohjes qendrore dhe klimatizimit në objektet e KPSH-së.
- Renovimi dhe mirëmbajtja e objekteve shëndetësore.
- Mbikëqyrja profesionale e projekteve gjatë realizimit.

2. Modernizimi i pajisjeve dhe teknologjisë shëndetësore

Aktivitete:

- Furnizimi me aparatura mjekësore dhe jo-mjekësore.
- Furnizimi me pajisje stomatologjike dhe laboratorike.
- Furnizimi me filma RTG, oksigjen dhe pajisje teknike.
- Mirëmbajtja dhe servisimi i pajisjeve mjekësore.
- Furnizimi me automjete për nevojat e QKMF-së.



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

- Instalimi i sistemit të zërimit dhe furnizimi me tendë për QKMF-në.

3. Sigurimi i furnizimit të vazhdueshëm me barna, materiale dhe shërbime mbështetëse

Aktivitete:

- Furnizimi me barna, reagenca laboratorike dhe material sanitar.
- Furnizimi me material stomatologjik dhe higjienik.
- Furnizimi me inventar për ordianca dhe zyra.
- Furnizimi me uniforma pune dhe libreza sanitare.
- Furnizimi me dru, pelet dhe pajisje shtëpiake.
- Sigurimi fizik, dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i objekteve.

4. Ofrimi i shërbimeve cilësore dhe gjithëpërfshirëse të kujdesit parësor

Aktivitete:

- Vizita specialistike dhe shërbime diagnostike.
- Kujdes shtëpiak, paliativ dhe geriatik.
- Shërbimet e urgjencës dhe shërbimi 24 orë.
- Shërbimet stomatologjike, pediatrike dhe internistike.
- Kujdesi për nëna dhe fëmijë.
- Vaksinimi i rregullt, kundër gripit sezonal dhe Covid-19.
- Shërbimet nga njësia diabetike.

5. Promovimi i shëndetit publik dhe aktivitetet parandaluese

Aktivitete:

- Organizimi i aktiviteteve për Ditët Botërore të Shëndetit dhe sëmundjeve.
- Fushata vetëdijesuese për kancerin, diabetin, HIV/AIDS, hipertensionin dhe TBC.
- Bashkëpunim me IKSHP për realizimin e aktiviteteve promovuese.
- Vizitat sistematike për nxënësit e shkollave.
- Përpunimi statistikor dhe prezantimi i të dhënave përmes workshopeve.

6. Ngritja e kapaciteteve profesionale dhe zhvillimi i burimeve njerëzore

Aktivitete:



Republika e Kosovës

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

- Trajnime profesionale të stafit shëndetësor në kuadër të ZHVP-së.
- Workshop-e për analizën e të dhënave shëndetësore.
- Furnizimi me shujta ditore për ekipet e vizitave sistematike.
- Transporti i stafit që udhëton mbi 5 km në vendin e punës.

7. Mbështetja sociale përmes subvencioneve dhe ndihmës financiare

Aktivitete:

- Shqyrtimi i kërkesave për subvencione gjatë gjithë vitit.
- Mbështetja financiare sipas kategorive të përcaktuara në rregullore.
- Trajtimi i kërkesave të bartura nga viti paraprak.
- Menaxhimi transparent i fondit të subvencioneve.

13. Drejtoria e Administratës

Ky plan i punës synon ta përmirësojë funksionimin e Administratës komunale, të sigurojë shërbime cilësore për qytetarët dhe ta rrisë efikasitetin e brendshëm të Drejtorisë së Administratës.

Objektivat dhe aktivitetet kryesore:

Zhvillimi i Burimeve Njerëzore dhe Organizimi

- Trajnimi i zyrtarëve komunalë për përmirësimin e shërbimeve.
- Harmonizimi i vendeve të punës dhe funksionimi i administratës.
- Angazhimi i ekspertit individual për hartimin e rregullores për sistematizimin e vendeve të punës dhe statutit të QKMF-së.
- Angazhimi i këshilltarëve për investime strategjike dhe koordinim të projekteve.

Shërbimet Operative dhe Mbështetëse.

- Sigurimi fizik i objekteve komunale.
- Mirëmbajtja dhe pastrimi i objekteve komunale.
- Shërbime mediale lokale dhe transmetime të drejtpërdrejta të ngjarjeve të kuvendit.
- Përkthime të dokumenteve zyrtare.
- Shërbime mbështetëse profesionale për ofrimin e shërbimeve publike për qytetarët.



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

- Shërbime kontraktuese të ndryshme.
- Transporti i punëtorëve të administratës.
- Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve komunale.
- Sigurimi i automjeteve zyrtare.
- Furnizimi me goma dhe karburant për automjetet e Komunës.

Investimet kapitale

- Ndërtimi dhe renovimi i objekteve komunale.
- Mirëmbajtja e vazhdueshme e objekteve.
- Blerja e veturave për nevojat e komunës.
- Blerja e kaldajave me pelet për objektet e administratës.
- Mirëmbajtja e inventarit dhe pajisjeve të punës.

Shërbime Administrative dhe Komunikim

- Shërbime shtypi dhe printimi.
- Shpenzime përfaqësimi ligjor të komunës.
- Informim dhe komunikim publik i ngjarjeve dhe aktiviteteve të komunës.

Furnizime të përgjithshme:

- Material higjienik dhe pastrim.
- Inventar dhe pajisje për nevojat e komunës.
- Pajisje dhe rroba për punëtorët teknikë dhe vozitësit.

Furnizime për zyra:

- Materiale zyre (letra A4, regjistrorë, fashikull, etj.).
- Kompjuterë dhe pajisje teknologjike.
- Klima për objektet komunale.
- Furnizim me kompjutera për nevojat e komunës.

Furnizime operative:

- Pelet dhe dru për ngrohje.
- Pije dhe qumësht për stafin e administratës.
- Flamuj dhe lule.



Republika e Kosovës

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Pra, bazuar ne fushat kryesore të veprimit, Drejtoria e Administratës për vitin 2026 ka si prioritet:

1. Rritjen e efikasitetit dhe profesionalizmit të stafit.
2. Sigurimin e funksionimit të qëndrueshëm të administratës komunale.
3. Përmirësimin e infrastrukturës dhe kushteve të punës.
4. Ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët.
5. Menaxhimin efikas të burimeve dhe logjistikës.

Plani i punës së kryetarit dhe drejtorive është plan dinamik pune, i cili mund të ndryshohet sipas kërkesave, nevojave dhe ndryshimit të rrethanave.

KRYETARI I KOMUNËS SË PRIZRENIT,

Shaqir Totaj

